VENDIM
Nr. 13, datë 6.2.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "SNOW ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa "a", 9 dhe 13, pika 1 germa "d", të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar, neneve 4, pika 1 germa "g", 5, pika 2, 13 dhe 14, pika 1, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.2.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Snow Energy" sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe të licencuarve të Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Snow Energy" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "f" dhe "g") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b" dhe "d") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10, germat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Snow Energy" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komsionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani